Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguese

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО:
ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DAL DY HERE NE JAVE:
T'ENJTEN DHE TE DIELLEN

Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 199 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorashkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 144 | **PRISHTINE, e diele 12 Shtatuer 1948** | Çmimi 2 dinarë

Protestime kundra fushates shpifse ndaj KQ te PKJ e Vendit t'one

Miting protestimi i kolektivit punues te minjeres se magnezitit „Golesh"

Kolektivi punues i sipermarrjes se minjeres „Golesh" e ka fitue per here e dyte flamurin kalimtar te Keshillit Popullor Krahinor dhe e ka plotsue planin e vet te prodhimit 21 dite para afatit te caktuem. Rezultatet e deritashme qe jane korre ne kete sipermarrje si dhe hovi i paparë i punetoreve, me te cilin luftojne per realizimin e te gjitha detyrave te tyne jane shprehje e dashunis ndaj udheheqjes socjaliste t'Vendit t'one. Ket dashtuni te pathyeshme kolektivi punues i minjeres se magnezitit „Golesh" e shprehu edhe me nji miting proteste qe u-mbajte para disa ditesh kundra fushates shpifse qe po bahet kundra KQ te PKJ, Vendit dhe popujve t'one.

„Me keto shpifje qe po i bahen Vendit t'one, nuk mundet te pajtohet asnji punetor, sepse nuk i kane merite as udheheqsat t'one, as Partija e jone dhe as shoku Tito — thuhet' ne telegramin qe ia derguen KQ te PKJ — e deri sa nuk e kane merituе, do te gabojshin rreptesisht te pranojshin até qe nuk asht e vertete. Na si klase punetore dijme ma se miri se shka na kane mesue dhe shka na kane tregue se si duhet me e dashte mbare popullin e udheshem liridashes, me e dashte Bashkimin Sovjetik — nanen e socjalizmit e te komunizmit dhe si me i dashte te gjithe popujt e tjere vllazen, si me e nderte socjalizmin dhe jeten ma te mire ne Vendin t'one, si me e urrye grabitçarin, portacin, kulakun dhe pasanikun e madh, etj.

Na çuditemi se si mundem disa udheheqsa te kompartive tjera me ba shpifje aq te padrejta, te trillueme dhe te pashtra, sepse tue e zhvillue fushaten anti-Jugosllave, bajne luftë kundra Frontit Demokratik, sepse keshtu e ndihmojne reakcjonin perjashta dhe mbrenda ne Vendin t'one. Na punetoret jemi te bashkuem fort rreth Komitetit t'one Qendror dhe shokut Tito dhe premtojme se me nji hov edhe ma te madh do te bajme çka te te jete e mundun per nderimin e socjalizmit, se do t'a perforcojme edhe ma teper vllaznimin e bashkimin e se do te naltesohemi ne pikpamjen kulturo-arsimore dhe do te luftojme kundra çdo padrejtesije, qe i bahet popullit t'one. Me vendosmeni e mprojme qendrimin se duhet te pushoje fushata shpifse kundra Vendit t'one dhe popullit t'one."

T'a shpejtesojme punen e kontraktimit dhe te çmuemit e prodhimit te misrit

Per blemjen e misrit, sivjet, egzistojne kushte shum te favorshme. Prodhimi i sivjetme asht ma i mire se sa ne vjetin e kaluem dhe dispozitat e Dekretit jane ma te favorshme se sa ma perpara. Mirepo, kontraktimi i drithit, i misrit dhe pregatitjet organizative e teknike, kane qene lane deri tash gadi krejt mbas dore, per shkak te punes se blemjes se drithnave te bardhe etj. Tash jane marre masa si nga ana e keshillave popullore ashtu dhe nga organet e blemjes dhe organizatat masovike. Per me gjithe ket, tue qene se deri-tash asht kontraktue nji sasi e vogel e misrit, duhet me e shpejtesue punen edhe ma.

Ne keto dite, perveç punes agjitacjone, politike e teknike per kontraktimin e misrit, duhet me i kushtue kujdesin e duhun edhe çashtjes se te çmuemit e prodhimit. Gadi ne te gjitha rrethet e Krahines s'one jane formue komisjonet perkatese. Tashma asht tue vazhdue puna kudo per te çmuemit e prodhimit te misrit. Te çmuemit e drejte, te shpejte dhe te perpiket te prodhimit asht nji parakusht i domosdoshem per realizimin e suksesshem te kontraktimit dhe te planit te blemjes se misrit. Me rastin e te çmuemit te prodhimit, komisjonet duhet te kujdesohen per kontrollimin dhe gjetjen e te gjitha siperfaqeve te mbjelluna me miser, mbasi me rastin e mbjelljeve nuk jane deklarue te gjitha siperfaqet, sidomos nga ana e pasanikeve te katundit. Ne ket menyre nuk do te mundet asnji spekulant me i ba bisht dorzimit te teprikave te detyrueshme te drithit. Duhet me u-kujdesue qe komisjonet te perbahen nga njerezit e ndershem punuesa te mesem te katundareve te cilet e kane provue qendrimin e tyne te ndershem dhe te drejte me rastin e te çmuemit te prodhimit te drithnave te bardhe dhe te cilet nuk anojne kah oportunizmi. Te çmuemit e drithnave te bardhe ka dhane eksperienca te mira, te cilat do t'ia ndihmojne organizatave te Partis dhe te Frontit popullor si dhe organeve perkatese te pushtetit popullor qe t'a kryejne me sukses kete pune te randesishme.

Perveç shpejtesimit te punes per kontraktim dhe per te çmuemit e prodhimit te misrit, luen rol mjaft me randesi dhe evidenca e organizueme mire. Kjo do t'iu ndihmoje organeve perkatese dhe do t'iu tregoje gjendjen reale te çdo prodhuesi si per kah siperfaqja e mbjellun me miser, ashtu edhe per kah prodhimi, teprikat e detyrueshme etj. dhe do te ndihmojne per zbulimin e keshimeve edhe te metave ne kohen e duhun.

Lavrimi i thelle-mas' e randesishme agro-teknike per prodhimin ma te nalte

Lavrimi i thelle i vjeshtes asht nji nga masat ma te randesishme dhe kryesore agroteknike per permirsimin e tokes, per punimin ma te lehte dhe per shtimin e prodhimit ne vjetin e ardhshem. Kete e ka provue fare kjarte praktika e deritashme. Tokat qe jane punue vjet ne rregull dhe ku asht ba lavrimi i thelle gjate vjeshtes, kane dhane prodhime shum ma te mdhaja se sa tokat, ku nuk asht ba lavrimi i thelle. Bima e mbjellun ne token qe lavrohet thelle, gjate vjeshtes rritet ma teper, jep ma shum prodhim, asht ma e qendrueshme ndaj motit te lig dhe e duron mjaft thatesin. Keto bime perparojne ma shpejte, e veçanerisht misri dhe patatet, kurse bimet industrijale as nuk duhet te mbillen ne token ku nuk asht ba ma pare lavrimi i thelle gjate vjeshtes. Eksperienca e deritashme ka tregue se sa randesi ka kjo mase agroteknike. Nuk ka asnji luftetar per prodhim ma te nalte qe nuk e konsideron kete si gjane ma te randesishmen, e cila i ka ndihmue ma e shtue prodhimin.

Me lavrimin e thelle mtesohet toka per thithjen dhe mbajtjen e gjate te lageshtines. Toka e lavrueme thelle dhe e imtueme mire ka mundesi me e mbajte ujin deri ne njifare shkalle te kulluemen, i cili u ndihmon pa mase organizmave te vegjel qe gjinden ne dhe e te cilet bahen ushqim i bimes.

Lavrimi i thelle bahet zakonisht mbas thyemjes se strnishtave, me te cilat ka fillue te bije bari i keq. Me lavrimin e thelle tri kater jave mbas thyemjes se strnishtave zhduken rranjat e barit te keq si dhe te bimave tjera qe i damtojne drithnat. Lavrimi i thelle e zhduk gjithashtu edhe kashten e strnishtave dhe e imton plehun e alurljeve.

Lavrimi i thelle tashma duhet te filloje. Nuk ka nevoje me pritë qe te bjere shi, vetem ne rast se asht fjala per livadhe, ledina ose ara te mbjelluna me terfoje. Ne keto te fundit, lavrimi i thelle duhet te bahet ne vjeshte mbasi te kete ra shi. Lavrimi i thelle mund te bahet deri ne fruer, ne qofte se lejojne kushtet atmosferike, por kjo nuk do te thote se duhet me e shtye edhe ma ket mase te randesishme. Per zbatimin e kesaj luejne rrol mjaftë me randesi edhe traktorat, sepse puna me keta asht ma e lehte, ma e shpejte dhe ma e mire.

Lavrimi duhet te bahet 20 cm. thelle per drithna ndersa per bime industrijale dhe patate 25 cm e ma teper.

Per zbatimin e kesaj mase duhet t'angazhohen seriozisht te gjithe bujqit, agronomet, stacjonet e maqinave e traktorave, kooperativat bujqesore ashtu dhe organizatat popullore. Organizatat e Partis dhe organizatat masovike ne katunde, si dhe kooperativat bujqesore, te cilat po e zgjanojne mjaft veprimtarin e tyne ne lamen e prodhimit bujqesor me anen e sektoreve te vet te ri, duhet te marrin mbi vedi si pjesen organizative te kesaj pune ashtu edhe te kujdesohen qe kjo mase te zbatohet ne kohe.

Plani i blemjes se drithnave te bardhe deri me daten 11 shtatuer asht realizue me 69,1%

Ne rrethin e Gjakoves dhe te Podujeves asht tejkalue plani, kurse rrethi i Dragashit nuk e ka fillue blemjen ende

rrethi	perqindja		
Vuçiternes	71,7	Kamenices	90,4
Gilanit	66,9	Podujeves	101,0
Prishtines	62,5	Ferizajt	62,7
Drenices	54	Pejes	99,8
Gjakoves	105,1	Rahovecit	74,6
Mitrovices	80,1	Liplanit	56
Istokut	63,4	Suharekes	71,2
		Prizrenit	66

Nga veprimtarija e akcjoneve te Frontit populluer te rrethit te Pejes

Ne mbledhjen plenare te keshillit te Frontit popullor te rrethit, te mbajtun pak dite perpara ne sallen e shtepis se shtallës fillore ne Peje, u-shqyrtue puna e deritashme e organizatave te Frontit. Me anen e referateve dhe te diskutimit te gjalle qe u-zhvillue n'akcjonet e ndryshme, u-konstatuen te metat e paraqitura dhe u-parashtruen detyrat e reja ne lidhje me punen e ardhshme. Shoku Ilija Gjukiq, sekretar i keshillit popullor te Frontit te rrethit skjaroi situaten politike dhe spjegoi ne hollsina randesin e Kongresit te Peste te PKJ-s, vuem ne dukje perpjekjet e jashtezakonshme te Partis s'one Komuniste qysh prej krijimit te saje e deri ne ditet e sotshme. Shoku Ismet Shaqiri nder te tjera tha: "Fronti si organizate masovike, ka marre persiper nji pjese te madhe te detyreve, e pra edhe jane si anetare te Frontit ne katund kemi detyra te mdha e bashi ne valen e punes se fushes. Duhet te dini e te jeni te vetdijshem se kjo perpjekje e pashembullt ne historin t'one asht per nji jete ma te mire te popullit punues ne katund e qytet dhe nji garanci qe jemi tue ndertue socjalizmin e Vendit t'one". Mandej i spjegoi akuzat e pathemelta te Byros Informative ne lidhje me qendrimin e udheheqjes se Partis Komuniste te Shqipnis, qe e karakterizoi si pamirenjohesi e, si thote nji fjale e urte popullore "ha buken e perndryshe kupen".

Aktiviteti dhe veprimtarija e Frontit popullor te rrethit prej kallnorit e kendej u-referue prej shokut Ragip Mahmutit. Organizatat e Frontit gjate kesaj periudhe kane pase rezultate te dukshme ne te gjitha sektoret e punes. Ata, me kete sakrifice kane tregue vetdijen e nalte politike, dashunin dhe detyrat qe i kane para shtetit, popullit e vendit. Frontistat e ketij rrethi e kane zhvillue hovin ma te madh te punes gjate garave per 1 Maj dhe ne nderе te Kongresit te V-te te PKJ. Ne punimet e ndryshme gjate garave te Nji Majit jane dhane ma se 100.000 ore pune, kurse n'ato te para Kongresit 311.246 ore pune vullnetare dhe 6088 dite pune me kafshe terheqse, qe arrijne vleften afer ne 7 miljone dinare. Gjate kesaj kohe ka qene mjaft e gjalle edhe puna kulturo-arsimore, jane mbajte 46 ligjirata te ndryshme. Ne kete rreth egzistojne 25 biblioteka te vogla e dy salla leximi.

Rezultatet e siperme na tregojne se Fronti Popullor asht i lidhun ngushte me Partin t'one dhe me udheheqsit e saje me shokun Tito ne krye. Gjate veprimtaris jane çfaqe te meta te ndryshme, kje fjala nuk u asht kushtue kujdes i duhun organizates se rinis e asaj te grues antifashiste, kur nuk llogarite punen e tyne ne raportet e keshillave te Frontit popullor te vendeve; evidenca akoma nuk ashte e rregullt dhe nuk shiqohet puna reale. Te gjitha keto, sado-kudo, e pengojne udheheqjen e drejte dhe zhvillimin e hovit te garave ne Front.

Ne kete menyre puna kalon per po u-rrejte per shkak te neglizhences apo mos-organizimi te mire t'evidences, siç kurse ka ndodhe ne Strellc, Rudnik, Leshan e Gllogjan.

Shtypi nuk asht i perhapun aq mire me gjithse mund nji sasi pajtimtaresh; ketij duhet t'i kushtohet nji randesi e madhe.

Ma teper kujdes per nxjerrjen e tatimit mbi trashigime e dhurata

Ne te gjitha keshillat popullore asht prue nji vendim i randesishem per caktimin per trashigim dhe dhurata. Pjesa e madhe e vetive te vendimeve kane hye ne fuqi e nuk zbatohen dhe, ne ket menyre nji shum e madhe t'ardhunash te keshillave popullore qendrojne tek debitoret e ndryshem. Kjo gja shkakton dhe mosrbatimin e rregullt te buxheteve te tyne.

Per realizimin e planit te pagimit te ketij tatimi egzistojne te gjitha kondtat objektive, e sidomos per ato vendime te cilat kane hye ne fuqi mbas ankesave dhe revizjonit te bame nga referati i Drejtorit t financjave te Keshillit Popullor Krahinor. I gjithe suksesi per pagimin e ketij tatimi mvaret prej angazhimit te keshillave popullore e kujdesteve financjare. Ket gja ma se miri e provon fakti se keshilli popullor i rrethit t'Istokut e ka realizue planin per muejin gusht me 250 per qind, kurse keshilli i qytetit-Peje, me gjithe se ka per te realizue ma se 1.400.000 dinare, nuk ka ba asgja. Gjithashtu, rezultate te dobta egzistojne ne rrethin e Gjakoves., ndersa ne te Pejes jane arrijte rezultate bukur te mira.

Me gjithse keshillat popullore jane te angazhueme me shum probleme tjera, sidomos tash, por tue pase ma shum kujdes, veçanerisht keshilli i qytetit te Pejes, kishin mundje me e realizue dhe me e tejkalue planin.

M. Q.

Prishtine:

Ne keto dite u-mbajte ne Prishtine konferenca e te gjithe kryetarve te kooperativave bujqesore te punes te rrethit te Prishtines, ku u-shqyrtue çashtja e shtimit te produktivitetit te punes. Ne lidhje me kete, u-vendos qe te zbatohen te gjitha masat agroteknike nga te gjitha kooperativat bujqesore te punes te ketij rrethi.

Perveç kesaj ne konferencen u-vendos qe te shpejtesohet punimi i godinave kooperative te filluema ma pare.

Plani -- kusht i doemosdoshem per zhvillimin e tregtis s' one socjaliste

Para disa ditesh ne Prishtine u mbajte konferenca krahinore me te gjithe pergjegjesat e sipermarrjeve tregtare dhe bashkimeve te kooperativave te rretheve ne lidhje me zbatimin e Dekretit te pagimit te personelit ne tregti simbas efektit te punes qe kryhet.

Simbas referatit dhe diskusjonit qe u-zhvillue ne mbledhje, u-konstatue se shumica e sipermarrjeve tregtare me gjithse Dekreti ka hy ne fuqi qysh me 1 kallnduer te ketij vjeti, ende s'asht zbatue prej shumices te sipermarrjeve te permendura.

Drejtorat e sipermarrjeve u-perpoqen me e justifikue kete te mete per shkak te mungeses s'artikujve te ndryshem dhe kuadrave. Per shembull perfaqsuesi i Mitrovices deklaroi se Dekretin e kane zbatue deri me muejin mars me sukses, por kur fillue mungesa e artikujve te ndryshem nuk qe i mundun zbatimi i Dekretit. Perfaqsuesi i kooperatives nga Ferizaj deklaroi se e kane provue zbatimin e Dekretit, por nuk qe e mundun prap per shkak te mungeses s'artikujve, sepse shitesit e dyqaneve s'mejshin me plotsue normen dituere dhe, rrogat mujore e tyne ishin fare e vogel. Vetem perfaqsuesi i magazines se rrethit te Pejes, qysh prej fillimit e ka vue ne zbatim Dekretin ne fjale pik per pike, me gjithse edhe ai asht ndodh ne te njajtat kondita sikurse te tjeret. Ai ka pase nji gja ma teper se shoket, e kjo asht kombe angulija dhe vendosmenija per pune.

Mandej u-konstatue se shumica e sipermarrjeve kane punue pa plan dhe normat nuk kane qene te caktueme realisht, njeni nga shkaqet kryesore qe e pengojshin zbatimin e Dekretit si per shembull ne Lipljan, Vuçiterne, Gilan etj.

Ne perfundim te kesaj mbledhjeje te gjithe pergjegjesat e sipermarrjeve muerren angazhime qe deri ne fund te ketij muaji t'a vejne ne zbatim Dekretin per pagimin simbas efektit te punes, t'i perpunojne planet e qarkullimit t'artikujve te ndryshem, t'i vejne ne veprim normat reale etj.

Ne fund e muerr fjalen i beneemi i Drejtorait te tregtis dhe furnizimit, shoku Sait Zatriq, i cili ndermjet te tjerave tha: "per me mujte me e plotsue detyren e vet tregtija e jone socjaliste, duhet pa tjeter qe nja te bahet me plan, sepse plani asht armika ma i madh i çrregullimit. F. sipermarrjet t'ona deri tash nuk kane punue me plan. Ka nji numer njerzish neper sipermarrjet t'ona, te cilat përpiqen me krijue veshtirsina te ndryshme vetem e vetem per me gjete shkaqe per justifikimin e mosplotsimit te detyrave, por s'duhet harrue se ka edhe t'atille, te cilet me te vertete perpiqen me mish e me shpirte qe te gjejne forma te ndryshme te punes ne perballimin e te gjitha veshtirsinave, gja qe e perforcon besimin qe na ka dhane populli dhe pushteti populluer.

Nji nga mungesat kryesore te drejtuesave te sipermarrjeve tregtare, asht qe nuk mesojne dhe nuk ngritesohen teorikisht. Nuk e mesojne teorin e marksizem-leninizmit mbi zhvillimin e tregtis socjaliste, e pa kete s'mund se bahen udhehqesa t'atie t'ekonomis. Nga kjo rrjedhe qe sipermarrjet t'ona tregtare nuk kane aspak iniciative, ende aty ketu dalin ne shesh veset e tregtis se vjeter: „Sa ma shum fitim". Me kete rast shoku Sait Zatriqi, vuni ne dukje shembullin e mire te sipermarrjes se hoteleve dhe restauranteve ne Peje, e cila me inisjativen e vet e ka formue ekonomin dhe, ne kete menyre e ka sigurue furnizimin e vet te rregullt e te mire. Keshtu duhet te punojne edhe sipermarrjet tjera.

Furnizimi i popullis ne qytetin e Pejes ka fillue te permiresohet

Furnizimi i popullsis ne qytetin e Pejes ma pare nuk bahej ne rregull. Ky çrregullim ishte rrjedhim i mosangazhimit te dalun dhe i qendrimit burokrat te disave nga personeli i ngarkuem per ket qellim. Mjafton me e permende faktin se disponimi e drithit per muejin gusht ka mberri me 17 t'atij mueji. Jo vetem kaq, por drithi ka qene i nji kualiteti te dobet, i perzien per mbi 40%. Per kete arsye nuk ka mujte me u-shperndae drithi me kohe, por vazhdoi deri ne fund te muejit.

Mandej, me gjithse qyteti ashtu dhe rrethi kane burime te mjaftueshme pemesh dhe perimesh, ata nuk çfrytezoheshin pothuejse fare e dyqanet e qytetit ishin te shumtet te zbrazta. Nga mos-interesimi i mjaftueshem i sipermarrjeve te furnizimit, kopshtijet kane qene tue dyqane spekulant, e inspekcjoni i tregut nuk i asht pergjegje detyres se vet, mbasi te per per shkak se personeli i tij ka qene i angazhuem me pune e detyre te tjera. Kooperativat bujqesore te katundeve nuk jane kujdesue aspak per blemjen e artikujve bujqesor, e organet e blemjes kane prite qe furnizimi i popullsis punuese te qytetit te sigurohet nga zyra.

Tue e pa kete gjendje e per me i dhane fund nji here e mire, para disa ditesh asht mbajte nji mbledhje ne mes t'organeve te Komisjonit kontrollues, te sipermarrjeve ekonomike dhe te perfaqsuesve te sekcjoneve te tregtis. Mbas nji diskusjoni, ku u-vuen ne dukje te gjitha te metat e lodhimet e deri-tashme, u-shtruen detyre konkrete per secilin, ne menyre qe furnizimi te permiresohet sa ma pare. Edhe ne realitet, me njihere, mbas ketij keshillimi, gjendja e furnizimit fillol te permiresohet. mbasi secili fillol me i zbatue perpikmenisht detyret e marruna persipe.

Tash dyqanet disponojne sasina ma te mdhaja pemesh e perimesh, dhe rrushit qe ma pare ishin aq te gjite pasur dyqaneve kane fillue te pakesohen dita dijtes. Te ketilla konferenca koordinimi do te mbahen ma shpesh ne t'ardhmen dhe asht nalre qe praktika e kille te zbatohet edhe n'ato rrethe ku furnizimi nuk asht ne nalltesin e duhun.

N. B.

Antaret e Frontit populluer te Drenovcit te Pejes nuk kursyen asgja per ndertimin e ures mbi Bistrice

Perpara shum vjetve, banoret e keshillit te vendit te Drenovcit kane andrrue ndertimin e ures ne lumin Bistrice, prane katundit Orabunice. Shpesh here, me inisjativen e tyne kane godite ura provizore, por te gjitha perpjekjet e tyne kane shkue kot mbasi porsa njet asht rrite, katundaret e kane pa uren e tyne te lundroje posi nji barke e shpartallume. Nuk jane te pakta viktimat qe kane mbete ne luhim te mushes e, te mos flasim per damet e ndryshme qe jane shkaktue ne gja te trashe, si bagti e qerre. Po, kujt t'i dhimbej e kuji t'ia hapshin zemren? Kujt t'ia qitshin dhimbjet, brengat e nevojat e tyne? Difur, ndreqja e kesaj ure, asht porhore si parolle agjitacioni me rastin e zgjedhjeve per deputet. Te gjithe kandidatet ne za e me fame per kollek e demagog per eksploatues si Mir Prota, Velimir Jojiq e Smajlin Begolli premtojshin pa kursim se „kane me votue per 'ta do t'a ndreqin uren". Votat dorzheshin here ne kutin e njenit e here ne ate te tjetrit, por ura per 20 vjete me rradhe na qe u-projektue.

Antaret e Frontit te ketij keshilli, te pifrulum prej pushtetit populluer e sukses dashiren e tyne ne ditet ma pallume te Vendit t'one. Ma e shpreshem me kete fjale kuqezin e tyne kur qene mbledhe per me e inaugurue ndertimin e ures me diten e pare te Kongresit te V-te te PKJ: „jemi ka qiellu, e jemi te sigurte se kjo ka me i pelqye edhe shokut Tito". Plaku Bajo Sarabiç, Haxhi Selimi prej Orabunice, me nipat te Gurfueme nga gezimi, kandohere qe i hje rasti me fole per te, thote: „ma fort m'asht ka qejfi qe asht ndreqe kjo ure se te me kishte fale ... 10.000 dinare".

Antaret e Frontit kane ka c'mos per ndertimin e saje. Nuk kane kursyen as mund ,as materjal, as lande, e çka ma teper, ata kane dhurue kuponat e tyne per me ble materjalin industrijal me qellim te lidhuna si ciment, gozhda (ba-kijat), vegla, hekur beton etj. Ura ne fjale asht e gjate 40 m. dhe e gjane 5,50 m. Tashma, ata s'kane pse te kene frige, mbasi ura asht e forte dhe stabel. Aji fillie rrethin e Pejes me ate te Rahovecit, Istokut e Gjakoves.

N. B.

PODUJEVE:

Simbas planit te Drejtoris Krahinore per fuqin punuese, asht parapa qe prej rrethit te Podujeves te dergohen 100 puntore te minjeren „Trepça", mirepo deri—tash plani asht tejkalue tue i dergue 136 puntore.

Akcjon i Frontit populluer te rrethit Prishtine ne rindertimin e rrugeve

Organizatat e Frontit populluer te rrethit te Graçanices duket qe me anen e konferencave t'ia spjegojne popullit randesin e meremetimit te rrugeve dhe t'organizojne pjesemarrjen sa ma te gjane te masave ne punen e meremetimit te rrugeve, e cila do te kryhet prej 19 deri me 26 te ketij mueji.

Simbas planit te gatshem ,ne rrugen Prishtine—Komoran do te punojne keshillat populllore te vendeve: Fushe-Kosove, Dobreve dhe Komoran. Ne rrugen Prishtine—Gilan do te punoje keshilli populluer i qytetit Prishtine dhe keshillat populllore te vendeve Graçanica dhe Sllovie. Keshilli populluer i qytetit Prishtine dhe keshilli populluer i vendit Lipjan Sojle do te punojne ne rrugen Prishtine—Liplan. Ne rrugen Prishtine—Kraljevo do te punojne keshilli populluer i qytetit Prishtine dhe keshillat populllore te vendeve Llukare dhe Kaçkoll, keshilli populluer i qytetit Prishtine dhe keshillat populllore te vendeve Devet Jugoviq dhe Besinje do te punojne ne rrugen Prishtine—Podujeve e ne rrugen Prishtine—Vuqiterne keshilli populluer i qytetit te Prishtines dhe keshillat populllore te vendeve Obiliq dhe Milloshevo. Mbasi keshilli populluer i vendit Mareve asht larg nga rrugat republikane, ai do te punoje ne rrugen me randesi te vendit Mareve—Slove.

Riorganizimi i kooperativave bujqesore ne rrethin e Pejes

Tue pase parasyshe faktin se sa i randesishem dhe i dobishem asht per kooperativistaen dhe bujqesin t'one ne pergjithsi, riorganizimi i kooperativave bujqesore, keshilli populluer dhe bashkimi i kooperativave te rrethit, ne frymen e konkludimeve te pranume ne mbledhjen e jashtezakonshme te kooperativave bujqesore te Serbis ne Beograd me 23 qershuer te k. v., filluen punen aktive rreth popullarizimit te ketij akcjoni. Shumica e kooperativistave neper keshillat e vendeve u-njoften me vendimin e bashkimit te kooperativave bujqesore te Serbis, me rregullat e reja te kooperativave bujqesore dhe me udhezimet per riorganizimin e tyne, neperniet t'aktivistave te Partis, kooperativistave ma aktive dhe organizatave masovike. Perpjekjet e ketyne aktivistave per kete çashtje ishin te mira, dhe, si rezultat i kesaj pune kemi kete, qe deri me 5 te ketij mueji u-mbajten pese mbledhje, ne te cilat kooperativistat u-njoften deri ne hollesina me rregullat dhe udhezimet e reja, tue prue ma ne fund vendimin per riorganizimin e tyne. Rezultatet ma te mira rreth kesaj pune arrijten ne mbledhjet e jashtezakonshme te kooperativave te vendeve ne Vitomirice, Zahaq, Raushiq, Borim dhe Trebeviq. Kooperativistat e te gjitha kooperativave te permenduna tue pa dhe kuptue, se riorganizimi i kooperativave bujqesore asht rruga ma e shkurte, ma e afertme per perparimin e te gjitha degeve ne bujqesi dhe ne kete menyre krijohen dhe epen mundesi per nji ardhmeni ma te lumtun — per socjalizem. Mbas per pasimit t'udhzimeve mbi riorganizimin e kooperativave dhe diskutimit, u-prue vendimi per te gjitha kooperativat e permenduna qe te formohen nder 'to keshillat e punimit simbas udhezimeve, perveç atij t'elektrifikimit, ndersa ky te formohet vetem ne Vitomirice, me qene se disponojne te gjitha kondilat objektive.

Veçanrisht terhjekese per kooperativistat ka qene formimi i keshillave per punimin e perbashket te tokes. Tue kuptue rrolin qe do t'a luej bashkimi i tyne ne punimet e bujqesis, ne Vitomirice me nji here mbas mbledhjes u-bashkuen 40 familje kooperativiste, ne Zahaq 31, ne Raushiq 23 etj. Nji dite ma vone ne Vitomirice numri i ketyne familjeve asht shtue ne 54.

M. Q.

Gara ne ndere te Kongresit te Pare te Sindikatave t' Unjisueme te Jugosllavis

Me rastin e pregaditjeve per Kongresin e Pare te Sindikatave t'Unjisueme, dega sindikale „Granap", e Prishtines u ka shpalle gara te gjitha degve sindikale te sipermarrjeve tregtare te Krahines s'one, rreth plotsimit per qind te planit te sipermarrjeve, rreth perfshimjes s'antarve te rij ne degen sindikale. Dega Sindikale e „Granapit" te Prishtines ka marre persiper me i zbrite cmimet e tregtis per 5 per qind, do te mbaje kater konferenca keshillimi, do t'i zhvilloje pese thema, do t'i mesoje shkrim e kendim te gjithe puntoret analfabete dhe do t'ape 37.000 ore pune vullnetare.

Kooperativat katundare te punes i sigurojne katundarit punues nji jete ma te mire dhe ma komode

Pjestaret e kooperatives bujqesore te punes te katunddit Matiqan, te rrethit te Prishtines beto dite e kane festue pervjetorin e dyte te themelimit te kooperatives se tyne te punes. Ne festim u-vuen ne dukje te gjitha sukseset e korruna gjate dy vjetve te kalueme dhe u-konstatue se antaret e kooperatives kane mundie me siguruе nji jete ma te mire e ma komode.

Te gjitha kulturat kane dhane prodhime te mira e sidomos zarzavatet. Gjate ketij vjeti, pjestaret e kooperatives kane ble 174 cope dele dhe 128 qingja.

Brigada e punes e kesaj kooperative asht e ndame ne kater grupe, prej te cilave ka merren me bujqesi e nji me pune ndertimit.

Pregaditjet per riorganizimin e kooperativave ne rrethin e Podujeves

Ne rrethin e Podujeves pregaditjet per riorganizimin e kooperativave bujqesore shit-blemse jane ne hov e siper. Bashkimi kooperativ i rrethit ne Podujeve i ka perpunue te gjitha udhezimet. Ne disa keshilla populllore te vendeve jane mbajte konferenca per çdo katund, ne te cilat i u spjegue popullit randesija e ketij riorganizimi per rekonstruimin e bujqesis s'one. Asht mbajte edhe mbledhja me keshillat drejtuese te kooperativave te vendeve. Me gjithse punet e ndryshme bujqesore tash jane ne hovin e plote, katundaret tregojne interesim te madh per kete akcjon, prandaj edhe ne te gjitha konferencat kane asistue mjaft njeres.

Banka e RFPJ lajmon terhekjen nga qarkullimi te banknotave 500 dinareshe

Banka Popullore e RFPJ-s lajmon se ministri i financave te RFPJ-s e prumi vendimin mbi leshimin ne qarkullim te banknotave te reja prej 500 din. te leshueme nga Banka Popullore e RFPJ-s, dhe mbi terhekjen dhe ndrrimin e banknotave prej 500 din. te JDF-fabrikim's shtetit.

Ne baze te ketij vendimi:

1. Ne diten 10 shtatuer te vjetit 1948 Banka Popullore e RFPJ-s i leshon ne qarkullim banknotat e fabrikimit te vet prej 500 din. me date 1 maj te vjetit 1946.

2. Banknota prej 500 din. e JDF e fabrikimit shteteror terhiqet nga qarkullimi dhe ndrrohet nji per nji, d.m.th. pa zbritje, ne relacjon 1:1. Terhekjen do t'a bej Banka Popullore e FDJ-s ne shubaret e veta te qendres kryesore, te qendrave dhe te te gjitha degeve te veta, me kohen prej 10 deri me 25 shtatuer te vjetit 1948.

3. Tue fillue prej 26 shtatuer te vjetit 1948 banknotat prej 500 din. te JDF te fabrikimit shteteror gjumbohen me fuqije si mjet pagimi, por mbas kesaj kohe mundem me u-ndrrue ne Banken popullore te RFPJ-s (ne qendren kryesore ne qendrat dhe ne te gjitha deget e veta) me nji afat prej dy muejsh d.m.th. deri me 25 nanduer te vjetit 1948.

4. Qe personave nga vendet larg prej vendeve te ndrrimit t'iu lehtesohet ndrrimi i banknotave prej 500 din. te JDF, keshilli populluer i mbledhe kete banknota prej popullsis ne ... e vet dhe duhet t'ia dergoje qendres ma t'afermë te bankes per ndrrim me aktin percjelles, te ndame prej dy muejsh, d.m.th. deri me 25 nanduer te ketij vjeti.

5. Zyrat, institutet dhe sipermarrjet duhet t'i sjellin te hollat e veta prej banknotave 500 din. te JDF me nji akt percjelles.

Zyrat shteterore, institutet dhe sipermarrjet mundem me e bo ndrrimin e banknotave prej 500 din. te JDF edhe per nepunesat dhe puntoret e vet, gjithashtu me akt percjelles dhe te ndame prej te hollave te tyne ne kete banknota.

Ne kete menyre do te kryhet ndrrimi i banknotave prej 500 din. te JDF edhe n'institutet ushtarake, komandat dhe njesit, me fjale tjera t'anetareve te tyne.

Arsim e kulturë

Per bibliotekat dhe sallat e leximit ne Krahinen t'one

Si Fronti, ashtu edhe pushteti i [illegible] popullor, tue pase gjithnji parasysh [illegible] e madhe qe [illegible] [illegible] te ngrihen ne nji nivel sa ma te nalte kultural — nji nder kushtet e domosdoshme per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one — po perpiqen me te gjitha mundesit me i krijue ato, qe kultura te bahet prone e te gjithe: punetorve, katundarve, intelektualve dhe e gjith qytetari ne Vendin t'one. Qe te realizohet kjo deshire asht [illegible] nji parapo ne plan, nuk do te mjaftonte me pase [illegible], biblioteka dhe salla leximi nder qytete, por edhe nder qendrat e keshillave te vendeve e nder katunde te tjera.

Tash per tash, ne Krahinen t'one kemi nji numer te mire sallash leximi — keto ma teper nder katunde, e ma pak biblioteka — keto ma teper neper qytete. [illegible] [illegible] popullit [illegible] [illegible] per tash te [illegible] bibliotekat dhe sallat e leximit nder te gjitha vendet ku [illegible] [illegible]. Per te pase [illegible] te mire dhe organizim ne mbajtjen e bibliotekave dhe te sallave te leximit, gjithnji me kujdesin e pushtetit popullor dhe te Frontit, para disa muejsh jane pergadit disa [illegible] nder kurse te posaçme, te cilet [illegible] punen nder to. Veç kesaj, me gjendjen e kulturit prej kursit te pergjegjesave te bibliotekave, qe ka qene hape ne Ferizaj, kane dale [illegible] 45 kuadra te reja, prej te cilve 23 shqiptare e 22 serbe. Ma teper se te tjeret kane dergue ne kurs rrethi i Pejes, i Podujeves, i Ferizajt dhe i Kamenices.

Te gjithe keta do te caktohen n'udhheqjen e punes nder bibliotekat dhe [illegible] te shtepijave kooperative. Ne kete menyre, te rijt e te re[illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible], [illegible] [illegible], [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] per profesjonin dhe jeten e tyne.

Ky [illegible] kursi do t'a vazhdoje punen e vet edhe gjate dimnit dhe pranveres s'ardhshme. Perveç kesaj, do t'aftesohen nder kurset e ardhshme edhe 120 pergjegjesa bibliotekash dhe sallash leximi.

Ne Peje po hapet shkolla tregtare dhe shkolla per kontabilitetin uniform-qe te dyja ne gjuhen shqipe

Me inisjativen e Keshillit Popullor Krahinuer — Komisjoni per shkolla dhe kurse — po hapen sivjet ne Peje: shkolla tregtare profesjonale dyvjeçare dhe shkolla dyvjeçare e kontabilitetit uniform, qe te dyja ne gjuhen shqipe.

Ne te dyja shkollat do te pranohen nga 60 nxanes, te cilet duhet t'a kene krye se paku shkollen fillore e qe te mos jene ma te ri se 14 e ma te vjeter se 24 vjeçe. Ne fund te dy vjetve, d.m.th. mbas mbarimit te shkollave, nxansit qe do te dalin me sukses do t'emnohen ne sektorin e tregtis. Shkollat e kane internatin dhe nxanesit do te kene gratis banesen, ushqimin dhe mjekimin. Lutjet per regjistrimin duhet me i paraqite deri me 25 te k.m. me anen e keshillave te rretheve.

Shtrohet si detyre e te gjithve e sidomos e organizates se Rinis popullore qe te bajn agjitacjon te gjane per t'u regjistrue ne keto shkolla numri i nevojshem i te rijve dhe te rejave ma te mira. Çdo te riut duhet me ia spjegue randesin e ketyne shkollave, dhe me u perpjeke per plotesimin e numrit te nevojshem sepse edhe keshtu shpejtesohet ndertimi i socjalizmit ne Vendin t'one.

Kursi tregtar i Mitrovices muer fund

Ne keto dite perfundoi punen kursi tregtar qe asht mbajte ne Mitrovice, ne te cilin kane marre pjese rregullisht 121 ndigjues, shumica shqiptar. Ne kete kurs kane marre pjese edhe disa te reja shqiptare, te cilat deri tash vone kane qene nen çarshaf. Keto kane korre sukses shum te mire. Asht dallue e reja Shane Beqiri, nga Mitrovica, e cila ka korre sukses te shkelqyshem.

Ne banketin qe u-mbajte, mbas mbarimit te kursit, te gjithe nxanesit deklaruen se do te sherbejnë kudo qe te jete nevoja, dhe se jane gadi ma ba ç'mos per perparimin e tregtis s'one te re socjaliste.

Asht per te vue ne dukje se nota ma te dobta kane dhane profesorat e historis dhe te gjeografis, te cilet kane kerkue nga kursistat aq sa kerkohet nga nxanesit e rregullt te shkollave te mesme, e nuk kane marre parasysh se kursistat kane qene vetem me shkolle fillore ose t'aftsuem me anen e kurseve analfabetike.

Kursi i udheheqesave per kurset analfabetike ne Sllatine

Delegati i Frontit Krahinuer — Si po shkon puna me kursin e udheheqsave qe e kane marre persiper mesuesi Mikush Stanimirowiq dhe mesuesja Tomara?

Katundar te Sllatines — Çfar te shkuene, kurse te ne as nuk ka filue kesi kursi.

Athue mesuesit e kane marre tashma aktin perkates apo jo?!

Fiskultura dhe Sporti

Ndeshjet finale per te marre pjese ne zonen e V-te

Ne periudhen prej dates 2 deri me 5 te ketij mueji jane perfundue ndeshjet finale per kualifikim per marrjen pjese ne zonen e V-te te footballit ne Serbi. Ne ndeshjet finale kane luejte Sh. S. „Polet" nga Prishtina dhe Sh. S. „Hylli i Kuq" nga Gilani. Ndeshja ne mes tyne perfundoi 2:3. Gjithashtu Sh. S. „Metohija" nga Prizreni asht dashte te luente me Sh. S. „Luftari" nga Ferizaj mirepo Sh. S. „Metohija" ka shkue ne krye te vet ne Tetove, ku ka zhvillue nji ndeshje miqsore dhe keshtu Sh. S. „Luftari" e fitoi ndeshjen zforfe 3:0 te Kosmetit ma se largit deri me 12 t'ketij mueji.

Zhvillimi i ndeshjeve per kupen e Jugoslavis

Sh. S. „Proleter" nga Prishtina e ka humbe ndeshjen e fundit me Sh. S. „Shojka" nga Trstenika me rezultat 2:0 Sh. S. „Trepça" nga Mitrovica ka humbe ndeshjen me Sh. S. „Sloga" nga Kraleva me nji rezultat 2:1. Prandaj Sh. S. „Proleter" dhe Sh. S. „Trepça" bijne nga zhvillimi i ndeshjeve per kupen e Jugoslavis.

SH. S. „Proleter" i Prishtines antare e liges se foot — ballit te R.P. te Serbis

Ne baze te vendimit te Bashkimit te foot-ballit te Serbis asht formue liga e foot-ballit te R. P. te Serbis, ne te cilen ka hye automatikisht Sh. S. „Proleter" nga Prishtina, kurse Sh. S. Trepça dhe Sh. S. „Jedinstvo" nga Zemuni do te luejne te dilen me 12 te ketij mueji ne Mitrovice. Fituesja ne ket ndeshje do te hyej gjithashtu ne ligen e Serbis.

Nga ndeshjet e zhvillueme deri tashper hyemjen ne zonen e ueste te Kosmetit jane kualifikue keto tete shoqni:

Sh. S. „Budoqnost" nga Peja, Sh. S. „Sanxhak" nga Novi Pazari, Sh. S. „Trepça" nga Mitrovica, Sh. S. „Vllaznija" nga Gjakova, Sh. S. „Hylli i Kuq" nga Gilani Sh. S. „Metohija" nga Prizreni, Sh. S. „Polet" nga Prishtina dhe Sh. S. „Luftetari" nga Ferizaj.

Ndeshjet e reja qe do te zhvillohen

Keshilli fiskultural i bashkimit te foot-ballit per Kosmet do t'organizoje ndeshje ne grup per kampjone ne Kosmet. Ne keto ndeshje do te marrin pjese te gjitha shoqnit qe kane ra nga ndeshjet e zones. Do te marrin pjese „Zhelezniçar" nga Fushe Kosova, „Vllaznija" nga Gjakova, „Sloga" nga Gilani, „Radnik" nga Vuçiterna, „Napredak" nga Istoku dhe „Dinamo" nga Podujeva. Shoqnit e permenduna duhet t'i par qesin deklaratat e tyne me shkrim keshillit te foot-ballit te bashkimit fiskultural te Kosmetit ma se largit deri me 12 t'ketij mueji.

Kurs i shkurte per refera

Me 12, 13 e 14 shtatuer do te mbahet ne Prishtine nji kurs i shkurt per kuadrin e ri te referave. Te gjithe referat e foot-ballit te Krahines s'one duhet te paraqiten me kohe ne Prishtine dhe te pregaditen per provime.

Ma se tete mije burra e gra kane pa çfaqje filmash gjate muejit gusht neper katunde

Kinemaja shetitse e Drejtorisë arsimuer te Keshillit Popullor Krahinuer asht tue i vizitue gadi te gjitha rrethet e Krahines s'one dhe po jep çfaqje filmash te ndryshem per popullin e katundeve. Gjate muejit gusht kinemaja shetitse ka vizitue shum katunde ne rrethin e Gjakoves, Pejes, Suhareks, Rahovecit dhe Dragashit. Tash gjindet ne terrenin e rrethit te Ferizajt, e mandej do te shkoje ne katundet e rrethit te Gilanit dhe te Kamenices. Kinemaja asht tue i çfaqe disa filma t'one dokumentare si dhe filmin sovjetik "Xhylbara". Populli i jone katundare çfaqe interesim te madh me rastin e çfaqjeve e sidomos per filmat t'one dokumentare. Gjate muejit gusht i kane pa çfaqjet e filmave te ndryshem ma se tete mije burra e gra te katundeve te te Krahines s'one.

PODUJEVE:

Ne Podujeve asht mbajte nji konference e antareve te deges sindikale, ku jane perpunue Statuti dhe Programi i Partis Komuniste te Jugosllavis. Thema asht zhvillue ne gjuhen serbe e shqipe nga shoku Rrahmon Bajrami, antar i Keshillit Ekzekutiv te keshillit sindikal te rrethit.

Skjarim per lexuesat t'one

Ne numrin 112 date 5—IX—1948 te gazetes s'one kemi lajmue se kursi i udheheqsave te kurseve analfabetike ne Mitrovice ka filue me nji shtatuer, ndersa ne te vertete ai ka nise disa dite ma vone. Ket lajm na e kemi marre nga i besuemi i arsimit per qytetin ne fjale, i cili nuk e ka dijte se shoqja Myzeref Raifi e ngarkueme me kete pune, ende kishte qene e zanun me mesime ne gjimnazin verue.

Kongresi botnuer i intelektualëve per mprojtjen e paqes

Kah mbarimi i gushtit, ne Vroclav ne Poloni, delegacjoni i intelektualeve t'one, muer pjese ne Kongresin botnuer t'intelektualeve per mprojtjen e paqes. Ne kete kongres kaq te randesishem ku mueren pjese perfaqsuesit e intiligjences se 37 shteteve te mbare botes, n'emen t'intelektualeve dhe te popujve te Jugosllavis, delegacjoni i yne e bashkoi zanin e vet per mprojtjen e paqes, e rrezikueme prej pregatitjeve pa kurrfare fetyra, te hapta te perleshjeve te reja nga ana e reakcjonit nderkombetar, me imperjalistat e Volstritit ne krye. Ne kongresin e Vroclavit, para syve te mbare njerzimit, edhe njihere u-ndie zani i atdheut t'one per perforcimin e solidaritetit nderkombetar, per bashkimin e qeverive, e te popujve demokrat te mbare botes ne lufte pa kompromise per paqen e drejte, lirin dhe kulturen, lufte kete qe do e udheheqe atdheu i fuqishem i Leninit e Stalinit, Bashkimi vila Sovjetik.

Ne blloku e demokracis kundra reakcjonit nderkombetar imperjalist, tue ndertue socjalizmin, popujt e Jugosllavis as per nji çast nuk i qesin mbas mendesh detyrat e tyne luftarake — faktin se lufta e tyne per ndertimin e socjalizmit asht pandajshmenisht e lidhun me luften e te gjithe popujve per paqen e drejte te forte, per thellimin dhe forcimin e solidaritetit luftarak nderkombetar kundra provokuesave te Volstritit dhe te tjerve te luftes.

Delegacjoni Jugosllav, perveç tjerash, ka theksue se Jugosllavija per sa i perket vijes se saje te jashtme — ajo ndjeke rrugen e solidaritetit nderkombetar dhe bashkepunimit vllaznuer per mprojtjen e paqes dhe kulturës, me Bashkimin Sovjetik ne krye.

Pikrisht dy vjete para ketij kongresi, kah mbarimi i gushtit te vjetit 1946, ne nji fjalim qe mbajti shoku Tito para punetorve te fabrikes se hekurit ne Jesenice, perveç tjerash thote: "lufta çlirimtare ka qene e rande. Nder vendet qe kane dhane theroria ma se shumti jane Bashkimi Sovjetik, Jugosllavija dhe Polonija. Por prap, sot ketyne vendeve nuk po u njihen fitimet kolosale dhe meritat e paçmueshme qe ato i kane fitue, tue bajte barren kryesore te kesaj lufte mbi shpatullat e veta.

Me ndertue nji paqe te drejte ka me qene pune e rande, por na do te luftojme gjithnji derisa t'a fitojme nji paqe me te vertete te drejte. Populli i yne asht liridashes dhe paqedashes. Prandaj s'ka kurkush te drejte me thane se na duem nji lufte te re, provokime te reja. Nji vend i vogel, sikurse asht Jugosllavija me 16 miljone banore, ne kete lufte ka dhane 1 miljon e 700 mije deshmore, bij e bija te saja ma te mire. Çka don me thane kjo? Kjo don me thane se Vendi i jone ka dhane çdo te dhetin qytetar te vetin. Populli i yne nuk deshiron kurrgja tjeter perveç paqes per me mujte te ngrihet.

Me keto fjale si edhe me nji varg deklaratash para dhe mbrapa kesaj vizite ke punetoret e Jesenices, shoku Tito e ka caktue kjartesisht rrugen fisnike te popujve t'one, te cilen rruge e ndjeke edhe inteligjenca e re, e lire krijuese e Jugosllavis se re. Ket rruge ajo do t'a ndjeke me entuzjazem, e patundun dhe e vendosun e, me ndere do t'i kryeje obligimet, qe nepermjet perfaqsuesave t'one ne kongresin e Vroclavit asht zotue me i krye.

Ne Kongres, n'emen te delegacjonit jugosllav foli akademiku Aleksandar Beliq, i cili perveç tjerash, tha:

„Ka qene krejtesisht gja e natyrshme te pritej se Kongresi per mprojtjen e paqes do te mbahej ne Vroclav, si pergjegje akcjonit rrenues te mitave imperjalista te luftes se re.

Edhe pak po te zgjatte lufta e dyte botnore, ne Vroclav nuk do te mbetej kurgja ne kambe. Ky qytet, dikur me 700.000 banore, do te kthehej ne hi e pluhun, sikur, fatkeqsisht i ka gjete shum qytete neper vendet e tjera.

Delegacjoni jugosllav, si perfaqsues i popujve te Jugosllavis, te cilet jane tue shkue rruges se ndertimit socjalist t'atdheut te vet, i pershendete referatet e paraqituna, objektivi i te cilave ka qene me zbulue rrezikun qe i kercnohet paqes ne bote, ne njenen ane dhe, me leshue kushtrimin per lufte kundra shkaktarve te saje, n'ane tjeter.

Delegacjoni vuni ne dukje, ne menyre te veçante, randesin e madhe te fakteve reale ne referatin e zotnis A. A. Fadejev, i cili e analizoi randesin sociologjike dhe psikologjike te te gjitha kushteve te punes kulturale, si te referatit te tij ashtu dhe n'ato te tjerve. Kjo analize u-ba me qellim qe, ne t'ardhmen te shmangjosen kundershtimet e konflikteve aktuale te mendimeve ne bote, konflikte keto kaq te rrezikshme per paqe nder mjet popujve kapitalista dhe atyne demokrate. Delegacjoni Jugosllav asht i lumtun qe mundet me e thane ketu se ne kete detyre fisnike, per te miren e paqes dhe lirise popujve, do te punoje me entuzjazem. Popujt e Jugosllavis jane te frymzuem me idene e bashkepunimit dhe ndihmes njeni kundrejt tjetrit, ne fushen e kultures, shkences dhe artit, e para se gjithash kundrejt popujve sllave, me bashkimin Sovjetik ne krye.

Jane ba tri vjet prej shlirimit t'one e kendej, per te cilin popujt t'one kane dhane shum theroria dhe Armata e lavdishme e Kuqe ndihmen te madhe, — merita dhe theroria e se cilës nuk do te mundem kurre me u-çmue due theksue aq sa duhet — tri vjet nuk jane kohe e gjate, kur e kemi fjalen per zhvillimin e kultures se popujve. Por, me gjithate, per kete kohe, ne kete fushe jane shenue perparime te mdhaja, ne fushen e ngritjes se turmave te popullit dhe n'ate te persosjes se shkences dhe artit te te gjithe popujve dhe republikave popullore te Jugosllavis. Une ketu nuk due me ju merzite me shifra, por mundem me ju kande se, mbrenda kesaj kohe te shkurte, ne shum dege, asht ba shum ma teper se sa per 25 vjete te Jugosllavis se vjeter. Ne kete drejtim Jugosllavija ngultaz do t'a vazhdoje edhe ne t'ardhmen zhvillimin e vet mbi bazat shkencore te Marksit—Engelsit—Leninit Stalinit. Te vueme ne keto baza, arsimi dhe kultura do te jane mjete te foqishme ne lufte per progresin dhe paqen.

Prandaj delegacjoni jugosllav e pershendete ket Kongres, si nji nga etapat ma me randesi ne ndertimin e paqes dhe liris ne bote. Kjo etape do t'a shtoje kuptimin e thelle te çdo njerin ne punen, qe bane, tue punue ne fushen e kultures, shkences perparimit t'ides, dhe ne likuidimin e te gjitha pengesave te paqes. Çdo punetor i t'ile, tue i dhane ndihmen e vet unitetit shkencuer dhe ndjesis artistike, bahet jo vetem kalores (fisnik) i shkences dhe artit, por edhe heroi i qytetnimit, perparimit dhe paqes se pergjithshme ne bote.

Çdo popull, tue zhvillue dhe thellue kulturen e vet, e cila shkelqen prej drites se krijimit te popullit, i jep ngjyren dhe shkelqimin kultures se pergjithshme te njerzimit, tue i dhane pasunin e permbajtjes dhe trajtes se kultures se vet, tue stimulue ma tej ne zhvillimin e saje.

Deshirojme qe çdo popull i cili ban pjese ne komunitetin per mprojtjen dhe forcimin e paqes ne bote, te punoje ne terrenin e vet, me popujt e vet, tue i perhape nder ta idete e ketilla dhe tue i ndrue ne kete menyre mendjet me te shqueme per çashtjen e pergjithshme.

Le te rrnoje dhe te zhvillohet njohja e njerzve njeni me tjetrin, e njerzve qe duhen ndermjet vedi dhe qe e duan te drejten, te cilet çajne rrugen e liris dhe paqes te te gjithe popujve, ashtu si te popullit te vet.

Le te rrnoje sa ka jete jeta dhe le te thellohet gjithnji ma teper puna e perbashket e njerzve perparimtare te te gjitha vendeve ne krijimin e nji kulture dhe qytetnimi te pergjithshem humanitar".

Nga situata nderkombtare

Antaret e Frontit na shkruejne

Nji nate ne hotelin "Lenjingrad" te Liplanit

Me ra rasti me kalue nji nate ne hotelin „Lenjingrad" te Liplanit.

Posa [illegible] t'errsohet mire, u-paraqita te pergjegjesi i hotelit per te zane nji shtrat. Vendi nuk m'u caktue perniiherë, mbassi arkatari vonoi [illegible] deri sa i kem dhane „formalitete" se a me me ba vend apo jo.

Kur e pveta ate se kush do te me drejtonte per me vendin e fjetjes, ai m'u pergjegj se duhej me prite derisa te [illegible] nga puna kamerieret, te cilet sherbejshin ne restaurant.

— Vetem nuk mundesh me e gjete dhomen, mbassi asht errët — me thote arkatari.

I prita ata deri sa u shliruen prej punes se restaurantit.

— A ke shkrepce — me thote kamerieri qe me shoqnonte per ne dhomen e fjetjes — se perndryshej nuk ke me pa se ku ke me hye.

U detyrova me dale jashte per me gjete nji qiri te disa shoke.

Shtrati i im, sikur te gjithe te tjeret ne vend te jastekut kishte nji botanil te palueme [illegible]. M'u deshte me shti edhe [illegible] t'ime nen te. Edhe pse [illegible] i forte, me bana nji gjume [illegible] fort te keq, mbassi isheni mjaft i lodhun.

Prej „rahatllekut", ne mengjesin e te nesermes m'ishte ngri qafa dhe s'mujsha me e hjedhe lirisht. Interesohem te pyes se si do t'ishte puna qe ai hotel kishte aq shume botanije sa me i perdore edhe ne vend te jastekve.

„S'kemi mujte ende me siguruе jastekë, mbassi qe sa here kemi dergue persona te posaçem per me marre pupla ne Vojvodine — me pergjigjet pergjegjesi i hotelit.

— Shum mjaft e drejte e ma mire do t'ishte qe kush per kush te sigurohen jastekët me kishte se sa klientat e hotelit te flejne me „jastek botanije" e me i pritë puplat e Vojvodines — i thom une atij.

M. B.

—o—

Librarija e Frontit ne Vuçiterne - mbyllet diten e pazarit

Te premten — dite pazarit ne Vuçiterne — shkova ne librarin e Frontit me i marre gazetat por ishte e mbyllun.

Shikova prej dritares ne poç [illegible] dores [illegible] disa zarfe — posta. Kjo tregonte se librarija s'ishte çele se pakti qe nga [illegible] e kalueme. Si spjegohet kjo? A thue se ne diten e pazarit nuk u-duka qe librarija te jete e hapet, apo sepse njerzve qe punojne ne te u duhet me krye nder dite te ketilla punet e tyne private?!

—o—

Libri i ankimeve ne restaurantin "Jadran" te Mitrovices

Klienti — Te lutem ma fal pak librin e ankimeve!

Kamerieri — po per çka po te duhet?

—o—

Nji rruge treni me dy lloj çmime biletash

Para disa ditesh m'u desht me udhtue me tren per ne Peje. Para biletarise ne stacjonin e Prishtines ishin grumbullue disa qinda njerzish. [illegible] rradha te marr biletën. Nga se biletashitësi me ndaloj vetem [illegible] dinare, une kujtova se mos do te kishte gabue ajo me me ndale 3 dinare ma pak, keshtu edhe per te tjeret. Ajo me kallxoi se kishte urdhen qe te [illegible] 3 dinare.

Mbassi kreva punet ne Peje, per [illegible] qe e mora ne stacjonin e trenit, paguva 36 dinare, keshtu edhe [illegible] te tjeret.

[illegible] si ka qene puna qe atje paguhej per bilete 36 dinare?!

[illegible] ka kete [illegible] udhtimi e [illegible] te çmimet stacjoni i Pejes?!

Lufta e popullit grek per liri dhe pamvaresi

Operacjonet me sukses t'armates Demokratika ne Krahinen e Olimpit

ATHINE

Radjostacjoni i Greqis i lire tranzmeton lajmin e agjensis „Elefteri Eilada" mbi operacjonet e Armates Demokratike ne sektorin Vici dhe ne krahinat e tjera te Greqis. Ne mes te tjerave, ne lajm thuhet se njisit'e Armates Demokratike me 5 shtatuer kane kalue i e kundra sulmin e pergjithshem ne sektorin Teropigi - Dendrohori. Njikohesisht, njisit'e tjera t'Armates Demokratike kane kalue ne mbrapavije te trupave monarko fashiste dhe kane krye sulme ne kampet dhe kolonat e anmikut. Monarko-fashistat ne keto luftime kane pase ma teper se 800 te vbekun dhe te plagosun, asht rexue nji aeroplan monarko-fashist dhe asht zane nji sasi e madhe materijali luftarak.

Njisit'e kavaleris dhe te kambsoris t'Armates Demokratike, te cilat baine operacjone ne Thesali, kane kalue gjate nates ndermjet te 1 dhe 2 shtatuerit ne krahinat e Olimpit dhe i kane thye fuqit monarko fashiste. Ne keto lufta jane shkatrrue 5 tanksa monarko-fashiste.

Nji numer i madh i te rijve nga katundet e Peloponezit u-bashkue me Armaten Demokratike. Simbas lajmeve te radio Athines te cilat i tranzmetoi radjostacjoni i Greqis se lire, njisit'e Armates Demokratike e sulmuen qytetin Tirnavos (Thesali) e thyen rezistencen e trupave monarko-fashiste dhe e mueren qytetin.

Radjostacjoni i Greqis se lire lajmon se ne fillimin e muejit te kaluem u-vra ne Selanik nen-kolonel i Armates Demokratike Micos Vanvakas, me rastin e kryemjes se nji detyre me randesi. Ministri ushtarak i qeveris se perkohshme demokratike te Greqis se lire e gradoi te ndyerin me graden e kolonelit, sepse jeten e vet ia kushtoi çlirimit dhe pamvaresis se Greqis.

Gjat'e nji nate monarko-fashistat burgosen 600 njerez ne Pire

ATHINE:

Agjensija „Tass" lajmon:

Gjate tane nates, ndermjet te 5 dhe 6 shtatuer, ne Pire u bane shtetrrethime, kontrollime dhe u burgosen ma teper se 600 njerez. Me kete rast monarko-fashistat e pushkatuen nji prift, sepse i kishte ndihmue partizanet.

Pergjigjeja e ministris se puneve te jashtme te Shqipnis sekretarit te pergjithshem t'organizates se Kombeve te Bashkueme, Trigve Lluf, ne lidhje me provokacjonet monarko-fashizte kunder Shqipnis

TIRANE:

Simbas lajmeve t'agjensis telegrafike shqiptare, Ministrija e Puneve te Jashtme te RP te Shqipnis iu pergjegj telegramit te sekretarit te pergjithshem t'organizates se Kombeve t Bashkuemene ne lidhje me akuzat e qeveris monarko-fashiste t'Athines kunder qeveris se RP te Shqipnis.

Ne kete pergjegje qeverija e RP te Shqipnis, ne mes te tjerave, i thekson provokacjonet e vazhdueshme nga ana e qeveris monarko-fashiste, "te cilat e cenojne sovranitetin dhe integritetin e qeveris se Shqipnis me koncentrimin e fuqive t'armatosuna te qeveris s'Athines ne kufinin e RP te Shqipnis, me ngacmimin e trupeve greke nga ana e shtypit t'Athines dhe te personaliteteve zyrtare greke qe te kalojne ne territorin e Shqipnis, keshtu qe t'i realizojne pretendimet e kota ekspansjoniste te shovenistave athinas, si edhe me agresjonin e armatosun, te cilin qeverija e Athines e ka krye me 2 shtatuer te vjetit 1948 tue dhane urdhen qe 3 batalione te monarko-fashistave te sulmojn ne territorin e Shqipnis".

Ne fund te pergjegjes thuhet se „faktet e permendona ma siper jane simptome, te cilat i zbulojne pregatitjet e qeveris s'Athines per nji situate e cila do te kete perfundime te damshme per paqe."

BERLIN:

Agjensija „Tass" lajmon:

Me rastin e vitit te trete te reformes agrare ne zonen sovjetike te okupueme ne Gjermani sekretorjati qendruer i Partis unike socjaliste te Gjermanis shpalli komunikaten, ne te cilen thohet:

Reforma agrare demokratike nuk ka qene vetem mase e nevojshme per sigurimin e furnizimit. Reforma agrare i sherben paqes sepse i ka zhduke bazat e imperializmit prusjan gjerman. Ne saje te reformes agrare, katundaret e vorfen dhe te mesem u bane fuqi kryesore ne katund. Ajo e transformoi katundin ne pikpamje politike, ekonomike, sociale dhe kulturale. Reforma agrare e ngjalli organizimin e ri katundar - shoqaten per ndihmen e perbashket katundare. Kjo organizate me te vetete demokratike bashke me kooperativat katundare do te bahen fuqija kryesore n'organizimin social dhe ekonomik te katundit. Reforma agrare demokratike ne zonen sovjetike t'okupueme ne Gjermani i ka lidhe puntoret industrijal dhe katundarin punues. Partija unike socialiste forcimin e ketij bashkimi e konsideron si nji detyre kryesore te veten. Puntoret industrijal dhe katundaret duhet te kontribuojne per plotesimin e planit dyvjeçar.

Lufta çlirimtare e popullit Kinez

Agjensija "Kina e re" e shpalle pasqyren e sukseseve dyvjeçare t'organeve te pushtetit popullor ne krahinat Shensi, Çahar, Hopei, Shantung dhe Honan.

Ne lamen reformes agrare, ne pasqyre theksohet se 21 milione e 500 mije banore ne keto krahina e shkeputen eksploatimin feudal dhe e realizuen reformen agrare. Personat e patoke dhe katundaret e vorfen mueren toke dhe vegla bujqesore. Katundarija e mesme e mbajti token e vet dhe muer vegla. Prej vjeshtes se kalueme e gjithe kjo krahine i filloi punet ne zhvillin e bujqesis dhe te produktivitetit industrijal.

Mandej ne pasqyre theksohet se ma teper se 80.000 luftarere plotsisht te pa-afte u asht siguruе jeteja. Disa qinda mije prej tyne jane kthye perseri n'armate dhe ma teper se 500.000 kane bye ne sigurimin popullor.

Gjithashtu jane mbrrijte suksese me randesi ne stabilizimin e çmimeve dhe ne zhvillimin e tregtis ne keto krahina, si edhe asht mbrrijte sukses i madh ne rritjen e shtazve dhe ne zhvillimin e industris moderne.

Ma ne fund paraqiten shenimet e aftesimit te kuadrave. N'universitetet e Kines veriore gjinden ma teper se 10.200 stydenta. Ne shkollat e mesme dhe profezjonale ka ma teper se 100.000 nxanesa dhe ne shkollat fillore 2.163.000 nxanesa.

Sipermarrjet lokale ne Krahinen t'one nuk kujdesohen mjaft per dorzimin e okumulacionit shtetnuer

Shumica e sipermarrjeve lokale ne krahinen t'one nuk i kushtojne kujdesin e duhun dorzimit te t'ardhunave, simbas planit financjar, me kohe, n'[illegible] e afatit. Ne kete menyre pengohet akumulimi i rregullt, e njikohesisht sigurimi i te hollave per plotsimin e planit.

Kjo gja rrjedhe nga shkaku se shumica e pergjegjesave te sipermarrjeve lokale nuk e kane kuptue randesin e akumulacionit ne zhvillimin e ekonomis s'one me plan. Mandej te shume pergjegjesa ende egzistan partikularizmi ekonomik, tue mendue se me perdorimin e t'ardhunave t'akumulacjonit ne sipermarrjen e vet, do t'a avansojne sipermarrjen e, nuk e shofin se ne rradhe e dantojne ekonomin t'one ne pergjithesi.

Si shembull karakteristik per ket gja jane sipermarrja e mullijve ne Prizren e cila nuk ka kurlar shenime mbi t'ardhunat qe ka pase deri me 1 Maj te kej viti, ne baze te cilave duhet te caktohet shuma per dorzimin me gjithe per ket gja ekzistojne blloka dhe formularet, te derguem per ate qellim nga Drejtorija i Tregtis te Keshillit Krahinuer. Sipermarrja e [illegible] dhe e restauranteve ne Prizren, qysh prej formimit te saje e deri tash nuk e ka dorzue asnji shume t'akumulacionit. Magazina e grurit ne Liplan nuk e ka dorzue t'akumit mbi t'ardhunat e punteve dhe nepermarre per 6 muej, me gjithse e ka ndalue prej atyne rregullisht.

Keshillat popullore, e veçanerisht seksionet financjare nuk kujdesohen per kei gja aspak, me gjithse detyra per kontrollimin e sipermarrjeve te kaja i takojne atyne ne rrandin e pare. Dhe ne qofte se ndonjihere bajne kontrollime, i bajne shkel e shkel pa hy ne thellesi te punes se sipermarrjes, se qysh e realizon planin e prodhimit e, ne baze te ketij dhe planin financiar. Edhe po te kete shenime, nuk shetjellet mire keshtu qe ne baze te ketyne t'i shofin dhe punet e sipermarrjes. Keshtu ndodhe ne keshillat e rretheve Liplan, Mitrovice, Ferizaj dhe ne Keshillin e qytetit Prizren.

Pra, me qene se ndodhemi ne vjetin e dyte te Planit pesvjeçar dhe kemi nji eksperience nga viti i kaluem gabime te ketilla nuk duhet te persetiten. Prandaj, keshillat popullore duhet te perpiqen me seriozitet per perzanteslimin e ketyne gabimeve dhe me ket menyre t'i ndihmojne sipermarrjet lokale per vepruitarin e rregullt e, ne te njajten kohe, t'a bajne te mundeshme realizimin e planit te zhvillimit ekonomik me kohe dhe me rezultatet e duhuna.

Do te bahen pyllzime te reja ne Krahinen t'one

Ne ket vjeshte ne Krahinen t'one do te bahet pyllzimi i shum siperfaqeve te zhveshtave. Simbas planit te Drejtorit bujqesuer-pyjuer te Keshillit Ekzekutiv Popullor Krahinuer do te mbillen 5 miljone fidane te ndryshme pyjesh ne 13 rrethe te Krahines t'one.

Eksperienca e deritashme tregoi se sistemi, i punes me brigada me rradhin e pyllzimeve ep rezultate ma te mira e shoqmu ne pikpamje te [illegible]. Per kete arsye edhe ne Krahinen t'one ne ket vjeshte do te veprohet ne ket menyre per pyllzimin e vendeve te zhdhuja. Ne lidhje me kete asht parapa qe, ne marreveshtje me organizatat e rinis popullore, deri me nji tetuer t'organizohen brigadat per pyllzimin e vendeve te zhdhuja, e prej nji deri me 5 tetuer te mbahet nji kurs i shkurte me udhehqesat e ketyne brigadave. Ne ket kurs udhehqesat do te njifen me teknikan e pyllzimit.

Fidanet per fudimin e pyllzimit te vjeshtes jane te siguruеme. Ne fidanishtet Krahinore te pyjeve deri me 15 te marsit te kalum jane prodhue 2 miljone fidane te ndryshme.

Qeverija e Robert Shumanit ra mbas dy ditve te formimit te saje

Agjensija Frans-pres njofton se Asambleja Popullore franceze ka votue kundra qeveris se Robert Shumanit me 295 kundra 289 votave, keshtu qeveris se permendun nuk iu dha besimi nga ana e Asamblea dhe u-detyrue me dhane dorehegjen dy dite mbas formimit te saje. Gjithashtu edhe kryetari i Asamblea Popullore Eduard Erio e ka dhane dorehegjen nga pozita e kryetarit te keshillit ekzekutiv te partis Radikale. Ane e mbane Vendit jane tue u-ba greva puntoresh te te gjitha kategorive.

PARIS: Korespondenti i Tanjugut njofton se mbas dorehegjes se qeveris sa formueme nga Rober Shumani, Kryetari i Republikes Franceze Vensan Orioli ia ka besue formimin e qeveris kryetarit t'Asambleja Popullore Eduard Erio-s, por ky e ka refuzue. Mandati mandej i asht besue kryetarit te partis Radikal-socjaliste Anri Keij, i cili e ka marre persiper dhe do te perpiqet me e formue qeverin e re.

BRSS, Polonija, Jugosllavija Rumanija, Bullgarija, Ungarija dhe Çekosllovakija e kane nenshkrue traktatin mbi komunikacjonin hekurudhuer.

VARSHAVE:

Korespondenti i Tanjugut njofton nga Varshava se ne Shkarlasko Porebni asht mbajt konferenca nderkombtare e perfaqsuesve, te komunikacjonit hekurudhuer te BRSS-s, Polonia, Jugosllavis, Rumanis, Bullgaris, Ungaris dhe te Çekosllovakis, ku asht nenshkrue traktati mbi organizimin e shoqnive kombetare per furnizimin e vagon-restauranteve dhe te vagonave per fjetje ne komunikacjonin e marrendeshem dhe nderkombetar.

Misjoni amerikan po i merr ne duert e veta gjithnji ma teper punet e qeveris s'Athines

ATHINE:

Agjensija "TASS" njofton se fletorja e Athines "Vima" ne nji artikull shprehe kepardhjen e vet qe misjoni amerikan ne Greqi gjithnji ma teper po i merr ne duer te veta punet e qeveris s'Athines. Fletorja thote se populli grek po e shef dita dites ma mire se po kufizohen vazhdimisht te drejtat e qeveris s'Athines, ndersa te drejtat e kompetencat misjonit amerikan po zhtohen. Qytetaret grek qe kane nevoje me iu drejtue per çdo fare pune qeveris s'Athines ose Ministarve te saje e quejne ma te nevojshme me bisedue njihere me ambasadorin ose me antaret e misjonit amerikan. Formohet bindja perfundon fletorja se n'Athine jane dy qeveri dhe njerizt nuk i mbushet mendja se qeverija e vendit ka gja ne dore, me gjithse kush ajo asht pergjegjese para popullit.

NEWJORK:

Agjensija Associeted-press njofton se jane bashkue me greven e shoferave 3500 shofera te tjere nga Nju Gjersija. Shoferat kerkojne shtimin e mediheve me nga 25 cent n'ore. Siç njofton agjensija Rajter jane bashkue me grevistat edhe ma se 40.000 transportues mbi lumin Hadson.

Ne bregdetin pacifik gjithnji po bajne greve 25 mije puntore limanesh. Puntoret kane refuzue me i ngarkue vaporet, qe transportojne materijal luftarak per Kinen e largët. Simbas lajmit te Rojterit pronaret e vaporave dhe pronarit humbin per çdo dite per shkak te ketij greve nga 4 milion dollare.

Ne Kalifornia dhe ne kater shtete te prendimore kane shpalle greve 15 mij puntore te rafinerive te vojgurit.

HAMBURG:

ADN lajmron se fletorja "Hamburgen Folksajtung" ne nji artikull me titullin "dhet fakte te pashkruesheme" mbi shkruen rezultatet e reformes monetare ne Gjermanin perendimore. Fletorja bashke me bilancin e reformes monetare cinon likuidimin e dyfishte te te gjitha bursimeve, mbrapambetjen e proporcionave ne sipermarrjen e ndermarrjeve t'anijave, pakesimin e grumbullimit dhe qarkullimin ne limanin e Hamburgut prej ket rrjedhim lexhime masovike te puntorve, presjon mbi mediat, shtimin e papunsis.

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Miladin Popoviq" Prishtine. Pajtimet ne fletoren i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906830.